

# A. M. P.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

## MAJ 2022

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

## MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

### Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




[ankesa@amp.gov.al](mailto:ankesa@amp.gov.al)



0800 90 90

### Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



[denonco@amp.gov.al](mailto:denonco@amp.gov.al)



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë

### Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

### Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



[www.amp.gov.al](http://www.amp.gov.al)



## Veprime hetimore

### Referimet e bëra në Prokurori

21 referime në Prokurori për 29 punonjës të Policisë së Shtetit dhe 11 shtetas për kryerjen e veprave të ndryshme penale.

Në kuadër të procedimeve penale të realizuara, të arrestuar/ndaluar dhe me masa sigurie nga Gjykata janë 9 punonjës të strukturave, si më poshtë vijon;

### Arrestuar/ndaluar në flagrancë

5 punonjës policie të arrestuar në flagrancë.

### Ekzekutimet e vendimeve të masave të sigurisë të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

#### Vendosur masa e sigurimit personal "Arrest me burg"

1 punonjës policie

#### Vendosur masa e sigurimit personal "Arrest në shtëpi"

1 punonjës policie

#### Vendosur masa e sigurimit personal me karakter ndalues "Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik"

2 punonjës policie

## Sektori i Sigurisë së Personelit

ka trajtuar e mbajtur korrespondencën shkresore me Institucione Shtetërore apo Agjenci ligjzbatuese për gjithsej 445 aplikantë dhe janë dërguar 557 praktika/kërkesa.

557 praktika/kërkesa të trajtuara

### Sipas objektit për verifikim sigurie:

- 292 Praktika/Kërkesa drejtuar agjencive ligjzbatuese
- 248 Praktika/Kërkesa/Njoftime drejtuar DPPSH-së
- 12 Kërkesa drejtuar institucioneve të drejtësisë
- 2 Njoftime drejtuar punonjësve të policisë
- 1 Praktikë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë
- 2 Praktika drejtuar Gardës së Republikës

445 subjekte

### Sipas subjektit të kërkesës për verifikim sigurie:

- 86 Punonjës Policie
- 4 Punonjës të Operatorëve Ekonomikë
- 97 Punonjës të Institucioneve Shtetërore
- 186 Punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes
- 36 Punonjës të AMP-së
- 36 Punonjës të Institucioneve të Drejtësisë

## HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun

**480 Telefonata**

në linjën e gjelbër **0800 90 90**, nga të cilat:

**195** telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP  
(Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

**72** telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP  
(Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

**213** telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit  
(Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



## INSPEKTIVE

Agjencia kryen inspektive pranë të gjitha subjekteve ndaj të cilave ushtron mbikëqyrjen në bazë të një plani të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe në bazë të veprimtarisë, apo një ngjarje të

Gjatë muajit Mars janë kryer **7** inspektive, nga të cilat:

**2** inspektive të planifikuara të strukturave policore

**5** inspektive të iniciuara nga dinamika e veprimtarisë së AMP

Në **1** rast është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **1** punonjës të PSH.

Më datë 25.05.2022, AMP ka monitoruar veprimtarinë e strukturave policore për sigurimin e rendit publik para, gjatë dhe pas zhvillimit të ndeshjes finale të Conference League në kuadër të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në Planin e Masave, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

## Ankesa të trajtuara

Ky grup nënkupton përfundimin e trajtimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes për qytetarin

**221 ankesa**

**91** ankesa për strukturën e **Rendit e Sigurisë Publike**

**72** ankesa për strukturën e **Policisë Rrugore**

**40** ankesa për strukturën e **Hetimit të Krimit**

**7** ankesa për strukturën e **Kufirit dhe Migracionit**

**3** ankesa për strukturën e **Shërbimeve Mbështetëse**

**2** ankesa për strukturën e **Burimeve Njerëzore**

**1** ankesë për strukturën e **Akademisë së Sigurisë**

**4** ankesë për strukturën e **Gardës së Republikës**

**1** ankesë për strukturën e **shërbimit Zjarrfikës**



## Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo anekese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

**177 ankesa**

**86** ankesa për strukturën e **Rendit e Sigurisë Publike**

**51** ankesa për strukturën e **Policisë Rrugore**

**32** ankesa për strukturën e **Hetimit të Krimit**

**2** ankesa për strukturën e **Kufirit dhe Migracionit**

**3** ankesë për strukturën e **Burimet Njerëzore**

**1** ankesë për strukturën e **AMP**

**2** ankesë për strukturën e **shërbimit Zjarrfikës**

